



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 448/ Prot.

Tiranë, më 13 . 2 .2024

V E N D I M

Nr. 9, Datë 13.2.2024

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR PROCEDURAT E VLERËSIMIT  
PERIODIK TË PUNËS PËR KËSHILLTARIN LIGJOR DHE EKONOMIK TË  
NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË  
KUALIFIKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 13, paragrafi “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 9, pika 1, paragrafi “ç”, të Rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, në mbledhjen e datës 13.2.2024, me votim unanimit, Komisioni,

V E N D O S I:

Në rregulloren “Për procedurat e vlerësimit periodik të punës për këshilltarin ligjor dhe ekonomik të njësisë së shërbimit ligjor të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. 65, datë 18.11.2019 të Mbledhjes, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1, në fund të fjalisë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Vlerësimi i punës së këshilltarëve për vitin 2024, kryhet brenda afatit të përcaktuar në pikën 8, të nenit 179/b të Kushtetutës”.
2. Reflektimin e këtij ndryshimi në rregulloren “Për procedurat e vlerësimit periodik të punës për këshilltarin ligjor dhe ekonomik të njësisë së shërbimit ligjor të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.
3. Njoftimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor të KPK-së për këtë ndryshim të rregullores.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Roland ILIA

